



Datë: 19.05.2025

Numër Protokolli: 3272/2025

A.nr.13/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari -anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.13/2025 të datës 06.01.2025 të parashtruar nga ankuesi N.A., kundër organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.05.2025 mori këtë

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.13/2025 e datës 06.01.2025 e parashtruar nga ankuesi N.A.

II. OBLIGOHET Udhëheqësi i Njësisë së Birimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, që të zbatojë këtë vendim brenda afatit prej 15 ditësh nga data e pranimit të tij, duke ndërmarr veprimet, që ankuesit t’i lëshoj Akt Emërimit për pozitën “Inspektor i Punës” në rajonin e Prizrenit.

III. OBLIGOHET Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën II.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit N.A. (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 06.01.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës, me pretendimet se pas përfundimit të procedurës nuk është lëshuar akti i emërimit siç parashihet me dispozitat ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.02.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë përmes emailit tek Inspektorati i Punës, ndërsa Këshilli më datë 03.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Inspektorati i Punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 32/2025 të datës 06.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kopja e konkursit me numër reference RN00011720; Emaili i datës 23.09.2024; Njoftimi i datës 27.07.2023 për kandidatin fitues; Shkresa e datës 03.08.2023 nga Menaxheri i Personelit; Vendimi A.nr.1145/2023 i datës 23.10.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi A.nr.1228/2023 i datës 01.11.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 11.01.2024 përmes emailit nga ankuesi për Menaxherin e Personelit; Aktvendimi PKR.nr.6/24 i datës 27.06.2024 i Gjykatës Themelore në Gjakovë; Emaili i datës 17.09.2024 – kërkesë për kthimin në vendin e punës; Emaili i datës 12.11.2024 ; Emaili i datës 14.11.2024; Kopja e letërnjoftimit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 19.02.2025; Përgjigje në ankesë e datës 03.04.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Aplikacioni i ankuesit N.A i datës 20.06.2023 bashkë me dokumentet e kërkuara; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 19.07.2023 dhe Pyetjet e intervistës me gojë për kandidatin N.A. nga anëtarët e komisionit.

Duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankesa e ankuesit është e **bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se Inspektorati i Punës, më datë 30.05.2024, ka shpall Konkursin për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00011720, për pozitën “Inspektor i Punës në rajonin e Prizrenit, klasa e pozitës Profesional 1, për tetë (8) pozita, ndërsa afati për aplikim ka qenë nga data 14.06.2023 deri më 17.11.2023, dhe ku sipas pikës 3 të konkursit, si kërkesa e përgjithshme për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në juridik, Shkencat Teknike, Arkitekturë dhe Kimi.*

Si rrjedhojë në bazë të kriterëve të konkursit ankuesi ka plotësuar të gjitha kriteret e konkursit si tek përgatitja profesionale po ashtu edhe tek përvoja e punës, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shqyrtimit të kësaj procedure konstaton se kjo procedurë e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 38 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Inspektorati i Punës më datë 19.07.2023 ka mbajtur intervistën me gojë ku kriteret i kanë plotësuar katër (4) kandidat por vetëm njëri prej kandidatëve në këtë rast ankuesi ka marrë pjesë në intervistën me gojë dhe ka marrë gjithsej 93.4 pikë, ndërsa tre

kandidatët tjerë nuk kanë marrë pjesë në intervistën me gojë këtë pozitë. Me datë 27.07.2023 Inspektorati i Punës ka shpallur njoftimin me numër protokolli 55/2023 për kandidatin fitues i cili ka marrë 93.4 pikë. Njësia e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës përmes shkresës të datës 03.08.2023 njofton se brenda afatit ligjor nuk ka pasur asnjë ankesë, prandaj rezultati mbetet i njëjtë.

Pas përfundimit të afatit të ankesave ndaj kësaj procedure të rekrutimit, ankuesi ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Personelit për tu pajisur me Akt Emërimin për pozitën Inspektor i Punës në Rajonin e Prizrenit, mirëpo Menaxheri i Burimeve Njerëzore i sqaron ankuesit se për tu pajisur me Akt emërim duhet prituri vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës, ku ankuesi ishte ankuar lidhur për shqiptimin e një mase disiplinore “vërejtje”. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 23.10.2023 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.1145/2023 me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit të datës 06.09.2023 duke anuluar masën disiplinore “Vërejtje” me nr.657/2023 të datës 22.08.2023 e shqiptuar nga Udhëheqësja e Divizionit dhe Koordinimit në Rajonin e Gjakovës. Më datë 14.11.2024 Menaxheri i Personelit në Inspektoratin e Punës përmes emailit e njofton ankuesin se pas pranimit të vendimit të Këshillit A.nr.1145/2023 ku është konstatuar se pjesëmarrja juaj nuk në konkurs ka qenë e ligjshme dhe nuk përbënë asnjë shkelje ligjore pas kësaj Njësia e Burimeve Njerëzore ka përgatitur Akt Emërimin për pozitën e punës Inspektor i Punës në Rajonin e Prizrenit, mirëpo nuk është dërguar ngase jam pezulluar menjëherë pas kthimit në vendin e punës dhe për këtë mund t’i drejtohet B.L., i cili pas kësaj përudhe është u.d. Menaxher i Personelit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se mos lëshimi i aktit të emërimit është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, duke kërkuar që ankesa të aprovohet dhe të obligohet institucioni të përgatit Akt Emërimin për pozitën që është përzgjedh.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se meqë ndaj procedurës së pranimit për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00011720, për pozitën “Inspektor i Punës në rajonin e Prizrenit, nuk ka pasur ankesa, dhe në këtë rast ankuesi ka rezultuar kandidat fitues, atëherë sipas dispozitave ligjore të aplikueshëm në kohën kur është zhvilluar procedura gjegjësisht sipas dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe dispozitat e nenit 51 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, institucionit ka qenë i obliguar që të lëshoj aktin e emërimit për pozitën përkatëse ngase e njëjta nuk ka qenë e kontestuar e që sipas shkresave të lëndës nuk ka një të tillë edhe pse sipas emailit të datës 14.11.2024 të Menaxherit të Personelit në Inspektoratin e Punës të dërguar për ankuesin konfirmohet se akt emërimi është përgatitur.

Marr parasysh faktin e pakontestueshëm që në shkresa të lëndës nuk dokumentohet se pala ka pranuar aktin e emetimit për pozitën që ka rezultuar kandidat fitues, atëherë në pikëpamje të këtij vendimi Inspektorati i Punës, gjegjësisht Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, është i obliguar që të ndërmarr të gjitha veprimet që ankuesit t’i lëshoj Akt Emërimin për pozitën “Inspektor i Punës” në rajonin e Prizrenit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, për rrjedhojë edhe pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.13/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit N.A.;
- Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së